

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RETAIL PARK SH.P.K.
ME SELI NË : GODINA BRUNES SPACE, KATI I 2-TE, PRANE QENDRA TREGTARE TEG, PERBALLE HYRJES
VJOLE RRUGA NACIONALE TIRANE-ELBASAN, FARKE, LUNDER,TIRANE
NIPT L71515042Q

VENDIM

I

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më **31.08.2022 (dy mijë e njëzet e dy)**, në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë **“Retail Park” Sh.p.k.**, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në “Godina Brunos Space, Kati I 2-Te, Prane Qendra Tregtare TEG, Perballe Hyrjes Vjole Rruga Nationale Tirane-Elbasan, Farke, Lunder,Tirane”, (më tej referuar si **“Shoqëria”**), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

“Balfin-Balkan Finance Investment Group” Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, - e cila zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin-Balkan Finance Investment Group (**“Ortaku i Vetëm”**).

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË RETAIL PARK SH.P.K.;**
- II. TE TJERA;**

Duke kaluar në diskutimin e çështjes së parë të Rendit të Ditës, Kryetari përshtrori se për nevojat e Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej **56,280,700 LEK** (pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind lekë). Financimi do të jepet në formën e kontributit në para të Ortakut të Vetëm me një vlerë të përgjithshme prej **56,280,700 LEK** (pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind lekë), në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga **233.317.946,05 LEK** (dyqind e tridhjetë e tre milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë zero pesë lekë) do të zmadhohet në **289.598.646,05 LEK** (dyqind e tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë zero presje pesë lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Retail Park sh.p.k. (NUIS: L71515042Q) me **56,280,700 LEK (pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind lekë)** ("Zmadhimi i Kapitalit");
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nënshkruhet dhe është shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetem në para, nga **Prilli 2022 deri ne 22.07.2022.**
- C. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga **233.317.946,05 LEK** (dyqind e tridhjetë e tre milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë zero pesë lekë) do të bëhet **289.598.646,05 LEK** (dyqind e tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë zero pesë lekë).
- D. Të autorizojë përdorimin e kapitalit të injektuar për investime të parashikuara nga Shoqëria.
- E. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË
RETAIL PARK SH.P.K.**

KRYETAR

Edlira Muka

ZNJ. EDLIRA MUKA



SEKRETAR

Eva Veizaj

ZNJ. EVA VEIZAJ